

## Relacion

### Mbi harttimin e raporteve te monitorimit viti 2024

#### 1.Lista e përmbajtjes së raportit të monitorimit të buxhetit

- Hyrje
- Informacion buxhtor i agreguar
- Performanca e treguesve kyç të performancës në bazë gjinore, nivel produkti
- Performanca e buxhetit në nivel programi
- Projektet kapitale
- Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit)
- Përfundime, ndryshime në buxhet

#### 2.Hyrje

Programi “Menaxhimi i të Ardhurave Doganore” është pjesë e grupit 10 Ministria e Financave dhe përbëhet nga 19 njësi ekonomike (Aparati + 18 Degë Doganore). Misioni i Administratës Doganore Shqiptare është të ruajë interesat financiarë dhe ekonomikë të Shqipërisë, të garantojë sigurinë dhe mbrojtjen e shoqërisë dhe të partnerëve tanë të biznesit duke u mbështetur në menaxhimin e riskut dhe kontrollë efikase dhe efektive të lehtësojë tregtinë duke implementuar metoda dhe teknologji moderne pune dhe të bashkëpunojë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me të gjithë aktorët përkatës.

Buxheti i akorduar programit është bazuar në Deklaratën e Politikës së Programit të hartuar gjatë procesit të PBA-së 2024-2026. Politika buxhetore e programit është fokusuar në përmbushjen në kohë të objektivave dhe detyrimeve ligjore si dhe të angazhimeve të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare në proceset e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Monitorimi i zbatimit të buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor 2024 për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar për të siguruar realizimin e qëllimit dhe objektivave të synuara të Institucionit. Nëpërmjet këtyre raporteve të monitorimit evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të miratuara në nivel kapitulli si dhe artikulli buxhetor si dhe treguesve të performancës dhe produkteve të parashikuara për tu realizuar. Realizimi i shpenzimeve të buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor 2024, paraqitet si më poshtë vijon:

në 000 lekë

Titulli	Emri i Programit	Buxheti fillestar 2024	Buxheti i rishikuar 2024	Fakti viti 2024	Realizimi %
01150	Menaxhimi i të ardhurave Doganore	4,574,257	3,926,327	3,721,633	95

**3. Informacion buxhetor i agreguar** Buxheti i fillestar i miratuar me anë të ligjit nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, programi buxhetor “Menaxhimi i të ardhurave doganore”, është 4,574,257 mijë lekë ndarë sipas zërave buxhetor; Shpenzime korrente 4,330,347 mijë lekë dhe shpenzime kapitale 243,910 mijë lekë. Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2024 ky plan ka pësuar ndryshimet në zërin e shpenzimet korrente si me poshtë:

1. Me shkresën e Ministrisë së Financave nr.760/1prot, datë 21.02.2024, është alokuar fondi i veçantë me vlerë 2,600 mijë lekë.
2. Me shkresën e Ministrisë së Financave nr.7288/1prot, datë 30.05.2024 është miratuar rialokim fondi për shpenzimet operative midis njësive ekonomike të institucionit tonë pa ndryshuar totalin e këtij artikulli për programin buxhetor.
3. Me anë të aktit normativ nr.3, datë 28.08.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar , për programin tonë jonë pakësuar fondet e shpenzimeve korrente produkti 91005AE “Shërbim i skanimit” në shumën 129,000 mijë lekë dhe janë shtuar shpenzimet kapitale në shumën 93.000 mijë lekë.
4. Me shkresën e Ministrisë së Financave nr .11767/1prot, datë 16.09.2024 me qëllim mbulimin e e efekteve financiare që rrjedhin nga politika e rritjes së pagave, është miratuar rialokim fondi për shpenzimet e personelit midis njësive ekonomike të institucionit pa ndryshuar totalin e këtyre shpenzimeve.
5. Me anë të aktit normativ nr.5, datë 19.12.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar , për programin tonë jonë pakësuar fondet e shpenzimeve korrente në shumën 406.500 mijë lekë, shpenzimet kapitale me financim të brendshëm 93.000 mijë lekë dhe ato me financim të huaj 120.000 mijë lekë.
6. Me shkresën e Ministrisë së Financave nr.8572/2prot, datë 01.10.2024, është akorduar shtesë fondi i veçantë me vlerë 2,000 mijë lekë.
7. Me shkresën e Ministrisë së Financave nr.17905/1prot, datë 31.12.2024, në zbatim të VKM nr.846,datë 26.12.2024 “Për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës të qeverisjes qendrore” është akorduar shtesë fondi i veçantë me vlerë 2,970 mijë lekë.

Në mënyrë të përmblëdhur buxheti i akorduar dhe realizuar për periudhën 2024 sipas zërave është:

në 000/lekë									
Art	Emërtimi	Fakti i vitit paraardhës 2023	Plan fillestar viti 2024	Akordim Fond i Vecantë	Akti normativ nr 3 dt 28.08.2024	Akti normativ nr. 5 dt 19.12.2024	Plan i rishikuar 2024	Realizuar 2024	Diferenca
600	Paga	1,245,253	1,488,607	-	-	-128,300	1,360,307	1,354,454	5,853
601	Sigurime Shoqërore	206,188	257,750	-	-	-33,000	224,750	222,861	1,889
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	2,264,083	2,573,191	-	-129,000	-245,200	2,198,991	2,100,173	98,818
605	Transferta Korente të Huaja	6,077	10,463	-	-	-	10,463	5,999	4,464
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	2,743	336	7,570	-	-	7,906	7,678	228
<b>I</b>	<b>Shpenzime korrente</b>	<b>3,724,344</b>	<b>4,330,347</b>	<b>7,570</b>	<b>-129,000</b>	<b>-406,500</b>	<b>3,802,417</b>	<b>3,691,165</b>	<b>111,252</b>
231	Kapitale të Trupëzuara	93,465	123,220	-	93,000	-93,000	123,220	30,464	92,756
	<b>Shp kapitale me financim të brendshëm</b>	<b>93,465</b>	<b>123,220</b>	<b>0</b>	<b>93,000</b>	<b>-93,000</b>	<b>123,220</b>	<b>30,464</b>	<b>92,756</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	-	120,690	-	-	-120,000	690	4	686
231	Kapitale të Trupëzuara	8,417	-	-	-	-	-	-	-
	<b>Shp kapitale me financim të huaj</b>	<b>8,417</b>	<b>120,690</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-120,000</b>	<b>690</b>	<b>4</b>	<b>686</b>
<b>II</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>101,882</b>	<b>243,910</b>	<b>-</b>	<b>93,000</b>	<b>-213,000</b>	<b>123,910</b>	<b>30,468</b>	<b>93,442</b>
<b>III</b>	<b>Shp nga të ardhurat jashtë limitit</b>	<b>180,589</b>	<b>0</b>				219,265	201,245	18,020
	<b>Totali (korrente + kapitale)</b>	<b>4,006,815</b>	<b>4,574,257</b>	<b>7,570</b>	<b>-36,000</b>	<b>-619,500</b>	<b>3,926,327</b>	<b>3,922,878</b>	<b>3,449</b>

#### 4. Performanca e treguesve kyç të performancës në bazë gjinore, nivel produkti.

Gjatë vitit 2024 numri faktik i punonjëve të administratës doganore ka qënë 966 nga të cilët femra 290 punonjëse. Numri i punonjëve të miratuar për administratën doganore është 1074 punonjës.

#### 5. Performanca e buxhetit në nivel programi

Qëllimi i Politikës së programit është: “Menaxhimi efektiv, efikas, i drejtë dhe transparent i të ardhurave doganore”. Treguesi i performancës është Mbledhja faktike e të ardhurave krahasuar me parashikimet. Për vitin 2024 ky tregues performace u realizua në masën 98% megjithëse vazhdon mbivlerësimi i monedhës lekë i cili ka një ndikim të konsiderueshëm në realizimin e planit të të ardhurave për administratën doganore, fenomen ky jashtë kontrollit të administratës sonë përsëri u arrit të realizohej plani i të ardhurave. Për vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 u realizuan të ardhurat në mld lekë:

Muaji	Realizim 2023	Realizim 2024	Plan 2024	% 2024-2023	Diferenca 2024-2023	Realizimi 2024 Realizimi 2023, %
Janar	14,832	15,058	15,033	101.5	227	1.5%
Shkurt	15,782	16,933	16,923	107.3	1,151	7.3%
Mars	17,286	18,105	18,088	104.7	819	4.7%
Prill	16,659	18,895	18,868	113.4	2,237	13.4%
Maj	19,659	20,776	20,774	105.7	1,117	5.7%
Qershor	18,769	20,240	20,247	107.8	1,471	7.8%
Korrik	18,842	21,320	21,316	113.2	2,478	13.2%
Gusht	19,701	21,421	21,416	108.7	1,719	8.7%
Shtator	18,461	18,486	20,506	100.1	26	0.1%
Tetor	19,182	19,232	20,417	100.3	50	0.3%
Nentor	18,524	18,577	19,692	100.3	53	0.3%
Dhjetor	19,340	20,562	21,691	106.3	1,223	6.3%
Progresive	<b>217,038</b>	<b>229,608</b>	<b>234,971</b>	<b>105.8</b>	<b>12,570</b>	<b>5.8%</b>

Objektivat kryesore të programit janë:

- Krijimi i lehtësirave për operatorët ekonomik nëpërmjet lehtësimit dhe përshpejtimit të procedurave doganore.
- Garantimi i sigurisë dhe i mbrojtjes kombëtarë nga: kontrabanda, trafiket paligjshme, mallrat e ndaluara e fallsifikuara, evazioni fiskal etj

Gjatë viteve të fundit, administrata doganore është udhëhequr nga parimi i transparencës dhe përgjegjshmërisë në raport me bizneset dhe qytetarët, në funksion të objektivave të saj, jo vetëm për mbledhjen e të ardhurave, por sidomos lehtësimin e procedurave dhe mbrojtjen e tregtisë së ligjshme dhe të ndershme. Administrata doganore ofron sot risitë më të fundit në proceset digjitale që lehtësojnë dhe përshpejtojnë procedurat doganore, nga zhdoganimi i mallrave të importit, deri në kontrollin e produkteve ushqimore, si dhe projekte të reja në ndihmë të biznesit. Marrëdhëniet e biznesit me Doganat janë përmirësuar ndjeshëm dhe në mënyrë të qëndrueshme 4 vitet e fundit, tashmë kemi arritur në 100% digjitalizim të shërbimeve doganore, dhe kjo tregon një stad tjetër të marrëdhënieve Doganë-Biznes

ADSH ka fuqizuar më tej aktivitetet dhe veprimet që kontribuojnë në sigurinë dhe mbrojtjen e shoqërisë, ruajtjen në të mirë të shëndetit të qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit. Një rëndësi e veçantë i luftës kundër pastrimit të parave, shkeljeve ndaj IPR si dhe Materialeve të ndaluara si drogave si dhe mallrat radioaktive.

Gjatë kësaj periudhe janë ushtruar kontrole në të gjithë territorin doganor, akset rrugore, si dhe në porte dhe hapësirat tona detare, ku përparësi kanë patur ngarkesat me mallra me risk, duke shfrytëzuar informacionet nga terreni, si dhe ato në dispozicion, sipas llojit të mallit, subjektit, klasifikimit tarifor, origjinës, por edhe kontrollet për trafiqe të paligjshme janë realizuar gjithsej 7478 inspektime doganore. Gjatë periudhës vitit 2024, nga Drejtoria e Antikontrabandës (Sektori Tokësor & Detar), janë realizuar 3,414 kontrole nga të cilat 1291 ose rreth 38% kanë qenë të plota. Gjatë kontrolleve të ushtruara, janë zbuluar 127 raste me shkelje doganore, ku 90 raste me penalitet, me një vlerë totale 30,121,200 lekë. Efektiviteti i kontrolleve me shkelje për periudhën Janar – Dhjetor 2024, rezulton në masën 6.97%.

Kontrollet, janë ushtruar në të gjithë territorin doganor, akset rrugore, si dhe në porte dhe hapësirat tona detare, ku përparësi kanë patur ngarkesat me mallra me risk, duke shfrytëzuar informacionet nga terreni, si dhe ato në dispozicion, sipas llojit të mallit, subjektit, klasifikimit tarifor, origjinës, por edhe kontrollet për trafiqe të paligjshme

Nga Drejtoria Antitrafik janë ushtruar 4064 kontrole dhe monitorime në Pikat e Kalimit Kufitar në Degët Doganore Durrës, Rinas, Qafë Thanë, Hani i Hotit, Vlore, Kakavije, Kapshtice Muriqan dhe Morinë ndaj individëve/udhëtarëve, automjeteve, mjeteve të transportit të udhëtarëve dhe mallrave. Për këtë periudhë kohore ka patur 40 raste të kapjeve/mosdeklarimeve cash-it.

Drejtoria e Hetimit, nisur nga informacione të strukturave të tjera të DPD-së, apo për çështje të nisura kryesisht pas mbledhjes së të dhënave si dhe kryerjes se veprimeve paraprake, mbi bazën e dyshimeve të arsyeshme për kryerjen e veprave penale të parashikuara në legjislacionin penal në fushën e doganave për shmangie të detyrimeve doganore apo detyrimeve të akcizës sipas përcaktimeve të nenit 277 të ligjit nr. 102 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar ka përgatitur dhe ka dërguar pranë Organit të Prokurorisë gjatë kësaj periudhe gjithsej 33 referime, janë konstatuar 14 shkelje doganore kundërvajtje administrative, janë konstatuar 87 shkelje doganore kontrabandë, janë dërguar Degëve Doganore 101 informacione për marrje vendimi. Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2024 kanë qenë në proces hetimi çështje me karakter sensitiv apo kërkesa për verifikim nga të cilat, janë trajtuar 3916 çështje dhe mbyllur 1484 çështje.

Realizimi i treguesve të performancës:

Treguesit e Performancës	viti 2023	viti 2024
Koha e procesimit të deklaratave doganore në kanal të verdhë	71'	60'
Koha e procesimit të deklaratave doganore në kanal in e kuq	507'	438'
Koha e procesimit të deklaratave doganore në kanal in jeshil	36'	36'
Numri i deklaratave doganore të procesuara në kanal in jeshil (në import)	125,703	155,064
Numri i deklaratave doganore të procesuara në kanal in jeshil (në export)	60,792	69,681
Numri i Operatorëve Ekonomik të Autorizuar (AEO)	13	16
Numri I grave qe punojne ne sistemin doganor	271	290

Koha e procesimit të deklaratave doganore është një ndër elementët më të rëndësishëm të performancës, të matshëm nga Organizata Botërore e Doganave. Kemi një ulje të kohës së përpunimit të deklaratave në të gjitha kanalet e riskut, që është edhe një ndër prioritetet e përmirësimeve proceduriale të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Në periudhën Janar-Dhjetor 2024 janë përpunuar 731,253 deklaratat doganore, është numri më i lartë i deklaratave të përpunuara nga administrata doganore, ku rritjen më të madhe e ofrojnë deklaratat e importit 4, të cilat janë edhe deklaratat që sjellin të ardhurat për administratën doganore, duke treguar edhe rritjen e numrit të deklarimeve në doganë.

Numri i Operatorëve Ekonomik të Autorizuar (AEO). Çertifikata “Operatori Ekonomik i Autorizuar”, është një status i lëshuar për “tregtarët me besueshmëri” të cilët mund të përfitojnë nga shumë thjeshtime doganore në kuadër të Marrëveshjes së Tregtisë mes vendeve të Ballkanit Perëndimor-CEFTA. Gjatë vitit 2023 e kane marrë këtë status edhe 3 operatorë ekonomik duke e çuar numrin e tyre në 13 gjithsej. Për periudhën Janar-Dhjetor 2024 e përfituan këtë status edhe 3 operatorë ekonomik të tjerë duke e çuar numrin e tyre në 16 gjithsej.

Plani fillestar, plani i rishikuar si dhe realizimi i artikujve buxhetor për periudhën Janar-Dhjetor 2024 paraqitet si më poshtë:

000/lekë

Art	Emërtimi	Plan fillestar	Plan rishikuar vjetor	Realizuar	% e realizimit ndaj planit të rishikuar
600	Paga	1,488,607	1,360,307	1,354,454	99.6
601	Sigurime Shoqërore	257,750	224,750	222,861	99
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	2,573,191	2,198,991	2,100,173	96
605	Transferta Korente të Huaja	10,463	10,463	5,999	57
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	336	7,906	7,678	97
231	Financim i brendshëm	123,220	123,220	30,464	25
230	Financim i Huaj	120,690	690	4	1
	Shuma	4,574,257	3,926,327	3,721,633	95

Realizimi i buxhetit të programit për periudhën Janar-Dhjetor 2024 është 95% e planit të rishikuar të shpenzimeve. Realizimin më të ulët e kanë patur fondet e parashikuara për investime si ato me financim të brendshëm edhe ato me financim të huaj.

U parashikuan të realizohen me fondet e miratuara të shpenzimeve korrente produktet e mëposhtme, ecuria e të cilave krahasuar me planin paraqitet si vijon:

në 000/ lekë

Kodi produktit	Produkti	shuma e planifikuar	shuma e realizuar	Sasia e realizuar
91005AA	Deklarata doganore të procesuara	2,089,343	2,032,600	731,253
91005AB	Vendime gjyqësore të ekzekutura	41,235	41,146	18
91005AC	Inspektime doganore të kryera	223,589	199,239	7,478
91005AD	Hetime doganore të kryera	13,000	6,196	1,484
91005AE	Shërbim i skanimit	1,435,250	1,411,983	5 vende
	Shuma	3,802,417	3,691,165	

## 6. Projektet Kapitale

Shpenzimet Kapitale me financim të brendshëm (art 230-231). Për vitin 2024 me anë të ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr.2349/4 datë 25.03.2024 “Dërgohet miratimi i detajimit të shpenzimeve kapitale për vitet 2024-2026” u planifikuar për tu realizuar investimeve në shumën 243,910 mijë lekë. Gjatë vitit me akt normativ u pakësua financimi i huaj në shumën 120,000 mijë lekë. Gjatë vitit u realizuan produktet si më poshtë:

në 000/ lekë

Kodi projektit	Përshkrimi	Shuma fillestare planifikuar	Shuma e rishikuar	Shuma realizuar	Sasia e realizuar
18AË101	Pajisje kompjuterike, licensa, softë	26,046	26,046	12,695	329
18AË103	Pajisje teknike	22,244	22,244	10,208	5
18AW104	Pajisje	3,631	3,631	1,648	51
18AW107	Blerje kabina kontrolli	4,000	4,000	1,128	2
18AW108	Skaner për kontroll bagazhesh	44,000	44,000	-	-
19AD102	Projekti PEN-CP në kuadër të Programit Horizon 2020	1,056	690	4	
GM10139	Kontratë shërbimi për Zhvillimin e Moduleve të ITMS (Sistemi i Menaxhimit të Integruar të Tarifës totalisht të përputhshëm me ITMS e BE-së	116,134	-	-	-
M100002	Blerje pajisje për Degët	3,932	3,932	3,040	143
M100024	Programi “Doganat” (fond i ngrire)	3,500	-	-	-
M100007	Blerje Pajisje	3,367	3,367	1,745	87
M100216	Blerje automjete dhe furgon	16,000	16,000	-	-
	Shuma	243,910	123,910	30,468	

## 7. Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit

Krahas fondeve të akorduara nga buxheti i shtetit gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2024 janë realizuar shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit si më poshtë:

në 000/lekë

Nr	Emërtimi	Fond i krijuar	Fond i realizuar
1	Shpenzime personeli (600+601)	62,541	60,336
2	Shpenzime të tjera korente (602)	11,198	10,238
3	Shpenzime kapitale (231)	5,656	3,405
4	Transferta korrente të brendshme (art 604)	139,870	127,266
	<b>TOTALI</b>	<b>219,265</b>	<b>201,245</b>

Në shpenzimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nga të ardhurat jashtë limitit përfshihen:

-Fondet e krijuara nga vendosja e sanksioneve doganore në zbatim të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.919, datë 29.12.2014 “Për miratimin e dispozitave zbatuese të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 285,

-Të ardhurat nga pagesat e kryera nga deklaruesit për shërbimin e kryerjes së analizave laboratorike për verifikime doganore, në zbatim të marrëveshjes së asistencës ndërmjet Agjencisë së Doganave Italiane, dhe Strukturës Përgjegjëse për Doganat Shqiptare në fushën e laboratorëve kimikë doganorë si dhe nga operatorët ekonomikë në ambientet e të cilëve ka prezencë të personelit doganor.

-Gjithashtu, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024 jnaë kryer transferta prej 127,266 mijë lekë njësave vendore për rentën minerare të shfytëzuar në teritorin e tyre (art 604) , në bazë të autorizimeve të lëshuara nga Ministria e Financave në zbatim të Ligjit nr.157/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.07.2008 ‘Për taksat kombëtare, të ndryshuar”, si dhe në zbatim të Udhëzimit nr.12 datë 04.04.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare’, të ndryshuar.

## **8. Përfundime**

Programi “Menaxhimi i të ardhurave doganore” e ka realizuar buxhetin e miratur për vitin 2024 në masën 95%. Për vitin 2025 prioritetet kryesore të Administratës Doganore do të jenë: Eficiencë, Siguri dhe Prosperitet për të përmirësuar të gjitha shërbimet doganore. Në mënyrë të veçantë, fokusi ka qenë dhe mbetet te zhvillimet e Teknologjisë së Informacionit dhe në bashkëpunim me AKSHI-n dhe UNCTAD që ofron sistemin ASYCUDA World, kemi modernizuar dhe digjitalizuar totalisht shërbimet doganore shqiptare. Risia e vitit 2025 do të jetë sërish drejt Inteligjencës Artificiale dhe operacionet data-driven për analizën e riskut, zbatimin e legjislacionit për të siguruar, jo vetëm të ardhurat në buxhet, por dhe kufijtë nga fenomenet e paligjshme, për të siguruar konkurrencën e ndershme dhe mbështetjen e zhvillimit të ekonomisë.